



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
KUVENDI KOMUNAL
MALISHEVË



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRILJENO:

Nr.No.Br:

13.05.2022

02/236

RREGULLORE PËR SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Malishevë, Maj 2022

Në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 1 dhe 2 pika c, nenit 17, nenit 24 paragrafi 2, nenit 40 paragrafi 2 pika a, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008, qershor 2008), nenit 17, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27/03 qershor 2008), nenit 2 të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.27/03 qershor 2008), nenit 36, paragrafi 3 të Rregullores Financiare Nr. 01/2013 - MF-Shpenzimi i parave publike, ftesës për njoftim publik Nr.04/276 datë: 12.04.2022, në bazë të nenit 10, nenit 19 paragrafi 7 pika e, nenit 37, nenit 38, nenit 40, të Statutit të Komunës së Malishevës Nr.01/871 të datës 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 13.05.2022 miraton këtë:

RREGULLORE PËR SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Me këtë draft rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë Komunës të ndajë mjete financiare pa kthim nga kategoria e subvencioneve për fushat e cekura në këtë draft rregullore për personat fizik dhe juridik.
2. Dispozitat e kësaj draft rregulloreje zbatohen nga organet dhe trupat komunale gjatë ndarjes së subvencioneve për përfituesit.

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë draft rregullore kanë këtë kuptim:

- 1.1. **Subvencionet** - në kuptim të kësaj rregulloreje përfshijnë transferet e njëanshme, të pakthyeshme të mjeteve buxhetore të institucionit, në llogarinë rrjedhëse të përfituesve, të ardhurat e të cilëve nuk mbulojnë shpenzimet e caktuara përkatëse për arritjen e një qëllimi të ligjshëm për interes publik.
- 1.2. **Pagesa e pakthyeshme** - është e njëanshme atëherë kur nuk ka mallra dhe shërbime që rrjedhin si kompensim ose kundërvlerë për pagesën.
- 1.3. **Përfituesi** - nënkupton personat fizik dhe juridik që përfitojnë mjete financiare nga kategoria e subvencioneve të planifikuar në Buxhetin e Komunës dhe në pajtim me Ligjin për ndarjet buxhetore.
- 1.4. **Banor rezident** - nënkupton personi që jeton dhe vepron në Komunë dhe posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës.

Neni 3

Limitet buxhetore

Komuna ndan subvencione duke u bazuar në Ligjin e buxhetit për Vitin fiskal për të cilën ndahen subvencionet dhe vetëm në masën e përcaktuar në këtë ligj.

Neni 4

Rregullat e përgjithshme të aplikimit për subvencione

1. Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve për persona fizik dhe juridik mbi bazën e kërkesës së tyre duke respektuar parimin e barazisë gjinore dhe në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore.
2. Personi fizik dhe juridik mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna nëse i ka të përfunduara obligimet ndaj Komunës.
3. Kushtëzimi me përfundimin e obligimeve ndaj institucioneve tjera të personit fizik dhe juridik mund të përcaktohet sipas fushave specifike nga vetë Komuna.
4. Komuna bashkë me hartimin dhe miratimin e buxhetit do të hartoj dhe miratoj edhe planin e ndarjes së subvencioneve sipas kategorive të propozuara në këtë draft rregullore.

Neni 5

Procedurat e përgjithshme për ndarjen e subvencione

1. Procedura e ndarjes së subvencioneve nga Komuna mund të zhvillohet mbi bazën e thirrjes publike apo në raste të veçanta në bazë të kërkesës së arsyetuar atëherë kur lejohet me dispozitat e kësaj draft rregulloreje.
2. Gjatë ndarjes së subvencioneve përmes thirrjes publike të Komunës përcaktohet qartë fusha e subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informata tjera me rëndësi.
3. Shqyrtimi i kërkesave dhe ndarja e subvencioneve mbi bazën e thirrjes publike zhvillohet sipas procedurave të parapara në nenin 7 të kësaj draft rregulloreje.
4. Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për ndarje të subvencioneve jashtë thirrjes publike të Komunës bëhet brenda 20 ditë pune nga parashtrimi i kërkesës.

Neni 6

Përfshirjet nga ndarja e subvencioneve

1. Përfitues të subvencioneve të ndara nga Komuna nuk mund të jenë personat fizik jo rezident të Komunës dhe personat rezident që zhvillojnë aktivitete jashtë komunës.
2. Personi fizik apo juridik vetëm një herë në vit mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna.
3. Përfshirje nga paragrafi 2 i këtij neni bëjnë subvencionet e ndara për persona fizik në fushën e shëndetësisë dhe për nevoja ushqimore, dhe mirëqenie sociale dhe personat juridik në fushën e kulturës, rinise dhe sportit të bazuara në kërkesa specifike.
4. Nëse me fajin e përfituesit nuk përmbushen obligimet e përcaktuara në vendimin apo me marrëveshjen për ndarjen e subvencioneve, për 3 (tre) vitet e ardhshme përfituesi humb të drejtën në përfitim nga secila kategori e subvencioneve.
5. Në rast se përfituesi i subvencionit të pranuar nga Komuna është person juridik dhe nuk arrin të realizoj qëllimin e subvencionit konfirmo marrëveshjes për subvencionim, përfituesi do të obligohet të kthej shumën e pranuar të mjeteve në tërësi ose pjesën e mbetur të pa realizuar konfirmo marrëveshjes.

Neni 7

Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve

1. Kryetari i Komunës emëron komision të përkohshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve në përbërje të përfaqësuesve nga fushat specifike të cilat formohen vetëm në rastet kur subvencionet ndahen përmes thirrjes publike për aplikim sepse në rastet tjera vendosin njësitë përkatëse sipas kërkesave të arsyetuara të palëve.
2. Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve veprojnë në pajtim me parimet e përgjithshme të ligjshmërisë dhe konfirmo autorizimeve, që jepen nga Kryetari i Komunës.
3. Përbërja e Komisionit duhet të jetë prej 3 anëtarëve, njëri nga anëtarët e komisionit duhet të jetë zyrtar i financave dhe një anëtarë mund ti jetë nga shoqëria civile që ka fushëveprim të ngjashëm me fushën që do të ndahet subvencioni, në rolin e vëzhguesit.
4. Përbërja e Komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.
5. Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve mbajnë përgjegjësinë për zbatimin e drejtë të kriterëve për ndarje të subvencioneve.

Neni 8

Vlerësimi i kërkesave dhe vendimmarrja

1. Komisioni bënë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve brenda afatit prej 20 ditë pune pas përfundimit të afatit të shpalljes publike.
2. Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve veprojnë në pajtim me legjislacionin për financat publike dhe dispozitat e kësaj rregulloreje si dhe legjislacionin në fuqi.
3. Rekomandimet e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.
4. Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e saj i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.
5. Komisioni i rekomandon Kryetarit të Komunës listën e përfituesve të subvencioneve në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike për ndarjen e subvencioneve dhe në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje si dhe i rekomandon marrjen e vendimit për ndarje të subvencioneve.
6. Kërkesat që nuk i plotësojnë kriteret për subvencione do të refuzohen nga Kryetari me rekomandim të Komisionit.
7. Komuna i njofton sa më shpejt që është e mundur të gjithë aplikuarit në baza individuale apo përmes shpalljes publike për përfshirjen ose jo në listën e përfituesve të subvencioneve dhe i njofton për të drejtën dhe procedurën e parashtrimit të ankesës.
8. Kryetari mund të kërkojë që Komisioni për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve të bëjë rivlerësimin e kërkesave apo të anulojë gjithë procesin e vlerësimit dhe të caktojë komision të ri për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve.

9. Kryetari merr vendim për ndarjen e subvencioneve në shumën deri në 1,000.00 (njëmijë euro), në përputhje me rekomandimin e Komisionit, në afat prej 5 ditë pune pas përfundimit të afatit të paraqitjes së ankesave të përcaktuar sipas Nenit 10 të kësaj Rregulloreje. Ndërsa për shumën mbi 1,000.00 (njëmijë euro), Kuvendi Komunal merr vendim për ndarjen e subvencioneve.
10. Kuvendi i Komunës i delegon kompetencën Komitetit për Politikë dhe Financa, për ndarjen e mjeteve financiare deri në shumën 500.00 (pesëqind euro) konform nenit 40 paragrafi 40.3, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, për ndarjen e subvencioneve-ndihma momentale për familjet me nevoja ekonomike dhe sociale.

Neni 9

Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve

1. Kryetari i Komunës emëron komisione me mandat tre vjeçar për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve në përbërje të përfaqësuesve nga fushat specifike vetëm në rastet kur subvencionet ndahen nëpërmjet thirrjes publike për aplikim.
2. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve duhet të jenë shërbyes civil. Komisioni do të jetë në përbërje prej 3 anëtarëve.
3. Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e saj i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.
4. Një anëtar i Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve duhet të jetë zyrtar ligjor.
5. Përbërja e Komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore
6. Anëtarë të Komisionit për vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve nuk mund të jenë zyrtarët të cilët kanë qenë pjesë e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve.

Neni 10

Parashtrimi dhe zgjidhja e ankesave

1. Ankesa parashtrohet në afat prej 5 ditë pune pas njoftimit të vendimit të Kryetarit të Komunës për mos ndarjen e subvencioneve.
2. Komisioni duhet të bëjë shqyrtimin e ankesave dhe të marrë vendim në afat prej 15 ditë pune pas përfundimit të afatit kohor për paraqitje të ankesave.
3. Komisioni për ankesa gjatë vendimmarrjes vepron në bazë të ligjit për procedurën administrative dhe dispozitave të kësaj rregulloreje.
4. Vendimet e Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.

Neni 11

Ekzekutimi i vendimit

1. Vendimi i Kryetarit për ndarjen e subvencioneve bëhet i ekzekutueshëm nëse:
 - 1.1. nuk është paraqitur ankesë sipas paragrafit 1 të nenit 12,
 - 1.2. me vendimin e komisionit të ankesave refuzohet ankesa.

Neni 12

Shpallja Publike për ndarjen e subvencioneve

1. Procesi i ndarjes së subvencioneve fillon përmes shpalljeve publike të cilat publikohen në faqen e komunës së Malishevës, rrjetet sociale, në vendet e frekuentuara si dhe në çdo vend tjetër të përshtatshëm.
2. Në shpallje përcaktohen saktë kriteret dhe procedurat për të aplikuar për ndarjen e subvencioneve të cilat përcaktohen sipas kësaj rregullore.
3. Shpallja publike qëndron e publikuar së paku 15 ditë pune nga data e shpalljes.

Neni 13

Marrëveshja për subvencionim

1. Për realizimin e subvencionit duhet të lidhet një marrëveshje në rastet specifike, me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrat në mes të komunës dhe përfituesit të subvencionit.
2. Marrëveshja duhet të përcaktojë subjektet nënshkruese të marrëveshjes, qëllimin, shumën e mjeteve financiare, afatet kohore, detyrat dhe përgjegjësitë e palëve, mbikëqyrjen, formën e subvencionimit, raportimin, hyrjen në fuqi si dhe pjesë tjera relevante për marrëveshjen.

Neni 14

Subvencionet për arsim

1. Komuna mund të ndajë subvencione për arsim duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1. Për nxënës në shkollë të mesme;
 - 1.2. Për nxënës në shkolla fillore;
 - 1.3. Nxënësit me nevoja të veçanta dhe për nxënës me kushte të rënda ekonomike;
 - 1.4. Gara apo kufizë (aktivitete jashtë mësimore);
 - 1.5. Botimin e librave/revistave;
 - 1.6. Nxënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
 - 1.7. Mësimdhënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
2. Kategoritë dhe shumat e subvencionimit do të përcaktohen me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës për çdo vit fiskal.

Neni 15

Kriteret dhe dokumentet që nevojiten për ndarjen e subvencioneve në arsim

1. Kryetari i Komunës me vendim të veçantë përcakton kriteret të qarta për dhënien e bursave duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në :
 - 1.1. Numri i nxënësve në familje;
 - 1.2. Kategoritë e dala nga lufta;
 - 1.3. Banimi në zona rurale;
 - 1.4. Rezultatet në gara;
 - 1.5. Gjendja ekonomike.
2. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të bursave përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 2.1. Dokumenti i identifikimit;

- 2.2. Vërtetim që është nxënësi i Komunës së Malishevës
- 2.3. Certifikatë e vendbanimit;
- 2.4. Dëshmia mbi gjendjen ekonomike;
- 2.5. Dëshmi se prindërit janë kategori të dala nga lufta;
- 2.6. Dëshmi për rezultatet në gara;
3. Komuna duhet të bëjë shpalljen publike për dhënien e subvencioneve e cila publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Malishevës, në vendet e frekuentuara, mediat sociale dhe në media lokale.

Neni 16

Subvencionet për shëndetësi dhe mirëqenie sociale

1. Komuna ndanë subvencione për banorët rezident për çështje shëndetësore dhe mirëqenie sociale
2. Subvencionet për shëndetësi jepen për:
 - 2.1. Rastet e rënda shëndetësore me gjendje të rënde ekonomike;
 - 2.2. Rastet e sëmundjeve jo të rënda por pa burim të të ardhurave;
 - 2.3. Trajtimi jashtë vendit;
 - 2.4. Lehonat pa burim të të ardhurave;
 - 2.5. Fushatat e vetëdijesimit për shëndetin publik;
 - 2.6. Personat me aftësi të kufizuara.
3. Gjatë ndarjes së subvencioneve në shëndetësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:
 - 3.1. Numri i anëtarëve të familjes;
 - 3.2. Çështja e banimit;
 - 3.3. Kostoja e trajtimit;
 - 3.4. Gjendja ekonomike familjare;
 - 3.5. Trajtimi në institucionet private (nëse një sëmundje e tillë nuk mund të trajtohet në institucionet publike).
4. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për shëndetësi dhe mirëqenie sociale nga personat fizik përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 4.1. Diagnoza e mjekut specialist;
 - 4.2. Dokumenti i identifikimit;
 - 4.3. Konfirmimin nga banka për xhironlogarinë e aplikuarit;
 - 4.4. Dëshmia e shpenzimeve mjekësore.
 - 4.5. Personat, për subvencionet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni mund të ndahen edhe pa shpallje publike por me kërkesë të arsyetuar
 - 4.6. Kartela e asistencës sociale (dëshmi)

Neni 17

Subvencionet për kulturë, rini, sport

1. Komuna mund të ndajë subvencione për OJQ-të dhe për individët për fuhen e kulturës, rinise dhe sportit duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1. Klubet sportive
 - 1.2. Sportistët e dalluar
 - 1.3. Garat sportive
 - 1.4. Shoqëritë amatore (ansamblet)
 - 1.5. Teatrot amatore

- 1.6. Festivalet
- 1.7. Botimi i librave
- 1.8. Ekspozitat me fotografi
- 1.9. Aktivitete me karaktere garuese
- 1.10. Pjesëmarrje në festivale jashtë komune dhe jashtë vendit
- 1.11. Promovim i librave
- 1.12. Promovim i talenteve të rinjë
- 1.13. Aktivitete, kulturore, rinore dhe sportive të organizuara nga DKRS
- 1.14. KVRL
- 1.15. Qendra Rinore
- 1.16. OJQ-te rinore
- 1.17. Klubet letrare
- 1.18. Shoqatat e ndryshme

2. Gjatë ndarjes së subvencioneve, në kushte të barabarta, Komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:

- 2.1. Projektet që kanë siguruar bashkëfinancim nga palët e treta sipas vlerës;
- 2.2. Projektet të cilat mund të gjen erojnë të hyra financiare për kërkuesin e subvencionit, në funksion të sigurimit të qëndrueshmërisë së projektit për periudhën e ardhshme;
- 2.3. Aplikativë që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencioni për kulturë, rini, sport të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër

3. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve përfshijnë, por duke mos u kufizuar:

- Projekt propozimi;
- Aplikacioni;
- Dokumenti identifikues;
- Certifikate e vendbanimit (për persona fizik);
- Certifikata e regjistrimit (për persona juridik);
- Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
- Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (për persona fizik);
- Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik);
- Konfirmimin nga banka për xhirrollogarinë e aplikuarit;

Neni 18

Subvencionet për Organizatat joqeveritare

Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve për OJQ-të aktive, konform dispozitave të Rregullores MF-Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ –VE.

Neni 19

Dokumentacioni i kërkuar për Organizatat joqeveritare

1. Organizata joqeveritare të cilët parashtrojnë kërkesë për mbështetje financiare duhet të prezantojnë dokumentacionin si vijon:

- 1.1. Certifikatën e regjistrimit të personit juridik,
- 1.2. Certifikatën e numrit fiskal,
- 1.3. Numrin e xhirrollogarisë bankare të personit juridik,

- 1.4. Fotokopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar Për tërheqjen e mjeteve,
- 1.5. Autorizimi,
- 1.6. Projekti,
- 1.7. Plani financiar,
- 1.8. Varësisht nga lloji i kërkesës mund të kërkohen edhe dëshmi tjera plotësuese.

Neni 20

Subvencionet për sindikatat e ndryshme

Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve për sindikatat e ndryshme që veprojnë në Komunë për realizimin e aktiviteteve dhe projekteve të tyre të ndryshme që janë me interes për Komunën. Ndarja e subvencioneve do të bëhet sipas kërkesave të tyre të arsyeshme sipas Vendimit të arsyetuar të Kryetarit të Komunës.

Neni 21

Dokumentacioni i kërkuar për sindikatat e ndryshme

1. Sindikatat e ndryshme të cilat parashtrojnë kërkesë për mbështetje financiare duhet të prezantojnë dokumentacionin si vijon:
 - 1.1. Aktvendimin e rexhistrimit
 - 1.2. Certifikatën e numrit fiskal
 - 1.3. Kopjen e kartelës së xhirollogarisë bankare të sindikatës
 - 1.4. Fotokopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar për tërheqjen e mjeteve
 - 1.5. Autorizimi
 - 1.6. Projekti
 - 1.7. Plani financiar
 - 1.8. Varësisht nga lloji i kërkesës mund të kërkohen edhe dëshmi tjera plotësuese

Neni 22

Subvencionet për mbulimin e shpenzimeve të varrimit

1. Komuna mund të subvencionoj mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e saj.
2. Kjo mbështetje financiare mund të ofrohet nga Komuna varësisht prej vlerësimit të arsyeshmërisë së nevojave apo kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve të ndryshme fetare konform akteve të kuvendit të komunës dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 23

Raportet kthyes nga përfituesit e subvencioneve

1. Përfituesit e subvencioneve të ndara nga Komuna obligohen që në Komunë të dorëzojnë raportin financiar dhe narrativ, përveç përfituesve në fushën e shëndetësisë, përkujdesje sociale dhe arsim.
2. Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas marrjes së subvencionit të dorëzojnë në komunë raportin financiar me të gjitha shpenzimet financiare ashtu siç janë kërkuar me projekt-propozim. Raporti duhet t'i ketë të gjitha shpenzimet e dokumentuara (raportet bankare, faturat e rregullta, nënshkrimet e pjesëmarrësve etj.).
3. Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas përfundimit të subvencioneve të dorëzojnë raportin narrativ i cili duhet t'i ketë të gjitha të dhënat e aktiviteteve janë realizuar gjatë zbatimit të projektit.

4. Periudha kohore e raportimit duhet të jetë 30 ditë pune pas përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në marrëveshjen në mes palës përfituese dhe komunës apo në vendimin e Kryetarit të Komunës.
5. Raportet nga paragrafi 1 i këtij neni protokollohen dhe një kopje e tyre dorëzohet në arkivin e komunës.

Neni 24

Monitorimi i përfituesve të subvencioneve

1. Komuna ka të drejtë të iniciojë auditimin e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve të ndara nga komuna në formë të subvencioneve.
2. Komuna mund të bëjë monitorimin e përfituesve të subvencioneve të përcaktuara në këtë rregullore, në lidhje me shfrytëzimin e drejtë dhe sipas vendimit apo marrëveshjes të mjeteve të ndara në formë të subvencioneve.
3. Monitorimi sipas paragrafit 2 mund të bëhet në periudhën kohore deri në 3 vite nga data e përfitimit të subvencionit.

Neni 25

Transparenca në ndarjen e subvencioneve

1. Komuna publikon listën përfundimtare të përfituesve të subvencioneve brenda 2 ditë pune pas vendimit për ndarje të subvencioneve nga Kryetari.
2. Lista përfundimtare e përfituesve duhet të përmbajë: emrin e përfituesit, rastin, fushën për të cilën jepet subvencioni dhe shumat që iu janë ndarë
3. Përgjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, komuna nuk i publikon subvencionet për rastet e përcaktuara në paragrafët 2.1, 2.2, 2.3, të nenit 17.
4. Publikimi i vendimeve dhe i përfituesve nga ndarja e subvencioneve bëhet në ueb faqen e Komunës, në tabelat e shpalljeve si dhe në vendet e frekuentuara në territorin e Komunës.

Neni 26

Dispozitat transitorë dhe shfuqizuese

1. Ndarja e subvencioneve e filluar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje vazhdon me rregullativën ekzistuese
2. Draft rregullorja rekomandohet për Kuvend nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa për aprovim

Neni 27

Ndryshimi dhe Plotësimi

Kjo Rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet në procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, me propozimet e arsyetuara nga propozuesi.

Neni 28
Zbatimi i Rregullores

Për zbatimin e kësaj Rregullore do të kujdeset Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Malishevës.

Neni 29
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohet rregullorja Nr.02/227 datë: 01.07.2020

Neni 30
Hyrja në fuqi

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, kjo Rregullore hynë në fuqi, sipas nenit 81, të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe plotësuar, me Rregulloren (QRK) nr.06/2021, përkatësisht pas shpalljes në faqen zyrtare të Komunës së Malishevës.

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaçi





REPUBLICA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVËS



**RREGULLORES PËR PLOTËSIM DHE
NDRYSHIM TË SUBVENCIONEVE DHE
TRANSFERAVE PËR VITIN 2022**

NJËSIA PËR KOMUNIKIM PUBLIK

Komuna e Malishevës përmes ekipit punues për hartim të **RREGULLORES PËR PLOTËSIM- NDRYSHIM PËR SUBVENCIONE DHE TRANSFERA PËR VITIN 2022**, duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Malishevës dhe Nenin 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018. për Konsultime Publike, Rregullore për Transparencë të Komunës së Malishevës

NJOFTIM PUBLIK

Lidhur me konsultimin e **RREGULLORES PËR PLOTËSIM -NDRYSHIM TË SUBVENCIONE DHE TRANSFERA PËR VITIN 2022**, ky dokument do të jetë në konsultim publik nga data 12.04.2022 deri me datën: 26 .04.2022.

Komentet dhe propozimet e juaja mund t'i dërgoni deri, më datën 26.04.2022, në ora 16:00 tek përgjegjësit, në formë fizike ose në e-mail adresat e zyrtarëve përgjegjës:
komuna.malisheve@rks-gov.net, kkmalisheve@gmail.com, artan.pacarizi@rks-gov.net,
izet.b.shala@rks-gov.net, blerta.d.krasniqi@rks-gov.net.

Për më shumë detaje për **RREGULLORE PËR SUBVENCIONE DHE TANSFERA VITIN 2022**, mund ta gjeni në linkun e ueb faqes zyrtare të Komunës së Malishevës: <https://kk.rks-gov.net/malisheve/category/dokumente/konsultime-publike/>, si dhe në platformën online të konsultimeve publike: <https://konsultimet.rks-gov.net/>

Malishevë, 12.04.2022

Dretori për Buxhet dhe Financa

Blerim Thaçi